

OUCH!

NË KËTË EDICION..

- Përmbledhje
- Gjetja e aplikacioneve
- Qasjet
- Përditësimi i Aplikacioneve

Përdorimi i sigurt i aplikacioneve Mobile

Përmbledhje

Pajisjet mobile si p.sh. tabletët dhe telefonët e avancuar (smartphones) janë bërë teknologji kryesore e përdorur në jetën tonë personale dhe profesionale. Ajo që i bën këto pajisje mobile aq të përdorshme janë miliona aplikacione në mesin e të cilave mund të zgjedhim. Këto aplikacioneve na mundësojnë të jemi më produktivë, të komunikojmë dhe të ndajmë informata me të tjerë, të trajnohem dhe edukohemi ose thjesht të zbavitemi. Por me fuqinë që kanë këto aplikacione mobile vijnë edhe rreziqet që ato mbartin. Më poshtë gjeni disa hapa që ju këshillohen për t'i përdorur dhe mirëmbajtur këto aplikacione në mënyrë të sigurt.

Botuesi i ftuar

Chris Crowley është një konsulent i pavarur, instruktor i certifikuar nga SANS si dhe autor i një kursi. Ai është aktiv në Twitter si [@CCrowMontance](#) dhe në Google plus: [+ChrisCrowley](#).

Gjetja e aplikacioneve mobile

Hapi i parë është të siguroheni që ju gjithmonë i shkarkoni aplikacioneve nga një vend i sigurt dhe i besueshëm. Kini parasysh një fakt, çdokush mund të krijojë një aplikacion mobil, prandaj duhet patur kujdes se nga kush merren ato. Kriminelët kibernetikë janë bërë të shkathët në krijimin dhe shpërndarjen e aplikacioneve mobile që duken si legjitime. Nëse e instaloni një aplikacion të tillë të infektuar, këta kriminelë mund të marrin kontrollin e pajisjes suaj mobile dhe të mund të lexojnë emailët tuaja, të dëgjojnë bisedat tuaja dhe të kopjojnë kontaktet tuaja. Duke i shkarkuar aplikacionet nga vende të besueshme, atëherë ju e ulni rrezikun e infektimit nga një aplikacion i infektuar.

Mund të mos e keni ditur, por lloji i pajisjes suaj mobile përcakton edhe mundësitë që keni. Për pajisjet e Apple sikurse iPad ose iPhone, ju mund t'i shkarkoni aplikacionet nga një ambient i mirëmbajtur, si Apple app store. Përparësia e kësaj mënyre është se Apple bën një kontroll të aplikacioneve dhe autorëve të tyre. Përderisa Apple nuk mund t'i ndalojë të gjithë njerëzit dashakeqë ose aplikacionet e infektuara, ky ambient i mirëmbajtur e redukton në masë të madhe rrezikun që ju të instaloni një aplikacion të infektuar. Gjithashtu, nëse Apple e gjen ndonjë aplikacion për të cilin beson se mund të jetë i infektuar, ata mund ta largojnë shumë shpejt atë nga ai vend.

Telefonët e Windows përdorin një mënyrë të ngjashme si më sipër. Telefonët Android janë ndryshe. Androidi ju jep më shumë fleksibilitet duke lejuar që një aplikacion të mund të merret nga kudo në Internet. Por me këtë fleksibilitet kërkohet edhe më shumë përgjegjësi. Ju duhet të jeni më i kujdesshëm se çfarë aplikacione shkarkoni dhe instaloni sepse jo të gjithë mbikqyren nga dikush. Google mirëmban një dyqan online të aplikacioneve mobile të ngjashëm

Përdorimi i sigurt i aplikacioneve Mobile

me atë të Apple, që quhet Google Play. Aplikacioneve mobile që shkarkohen nga Google Play janë kontrolluar në mënyrë bazike. Prandaj ne ju rekomandojmë që t'i shkarkoni aplikacionet mobile për Android vetëm nga Google Play.

Evitoni shkarkimin e aplikacioneve mobile për Android nga faqe tjera, sepse çdokush, duke përfshirë edhe kriminelë kibernetikë mund të krijojnë dhe shpërndajnë aplikacione mobile, t'ju mashtrojnë juve që t'ju infektojnë pajisjet tuaja mobile. Si masë shtesë mbrojtëse, merrni parasysh edhe instalimin e një anti-virusi në pajisjen tuaj mobile.

Per ta ulur rrezikun edhe më shumë, evitoni aplikacionet që janë shumë të reja, ato që janë shkarkuar nga shumë pak njerëz, ose ato që kanë shumë pak komente pozitive. Sa më shumë që ka qarkulluar një aplikacion apo ka komente pozitive, ka më shumë gjasa që ai aplikacion të jetë më i besueshëm. Poashtu, instaloni vetëm aplikacionet që vërtet ju duhen dhe i përdorni.

Pyesni veten, a më duhet vërtet ky aplikacion? Jo vetëm që një aplikacion sjell probleme të mundshme, por edhe mund të çënojë privatësinë tuaj. Nëse nuk e përdorni një aplikacion, largojeni nga pajisja juaj mobile (dhe mund ta instaloni përsëri kur t'ju duhet).

Në fund, ju mund të tundoheni ta hiqni kufizimin (ang. jailbreak ose root) në pajisjen tuaj mobile. Ky është procesi i hakimit brenda pajisjes dhe instalimit të aplikacioneve të paaprovuara ose largimit të funksionaliteteve ekzistuese. Ne ju rekomandojmë të mos e bëni këtë proces, sepse jo vetëm se anashkalon disa kontrole të sigurisë por edhe shkakton humbjen e garancisë apo kontratës së mirmbajtjes së pajisjes suaj mobile.

Qasjet

Pasi të keni instaluar një aplikacion mobil nga një burim i besueshëm, hapi tjetër është të siguroheni që është i konfiguruar si duhet dhe mbron privatësinë tuaj. Instalimi apo konfigurimi i aplikacioneve mobile shpesh kërkon edhe dhënien e disa qasjeve. Gjithmonë mendoni para autorizimit të qasjeve, a ka vërtet nevojë ai aplikacion për ato qasje për të kryer punën që ju duhet? P.sh. disa aplikacione përdorin shërbimet për gjeo-lokacion. Nëse ju i lejoni një aplikacioni të dijë lokacionin tuaj, ju mund të jeni duke i lejuar krijuesit të atij aplikacioni të dijë çdo lëvizje tuajën, madje edhe mund t'ia shesin dikujt këtë informatë. Nëse nuk doni t'ia jepni këto qasje një aplikacioni, atëherë kërkonit një tjetër aplikacion që ju plotëson nevojat tuaja. Kini parasysh që keni plot zgjedhje. Pajisjet e Apple lejojnë që disa qasje të ndryshohen te Settings apo gjatë ekzekutimit të aplikacioneve, si p.sh. informata mbi gjeo-lokacion. Pajisjet Windows dhe Android janë ndryshe, ato përdorin mënyrën gjithçka ose asgje. Nëse nuk i lejoni qasjet që kërkon një aplikacion, nuk mund ta instaloni atë.



Çelësi për përdorimin e sigurt të aplikacioneve mobile qëndron në instalimin e aplikacioneve vetëm nga burime të sigurta dhe sigurohuni që aplikacionet tuaja janë të përditësuara dhe ju keni verifikuar qasjet e kërkuara.

Përdorimi i sigurt i aplikacioneve Mobile

Përditësimi i Aplikacioneve

Aplikacionet mobile, si çdo kompjuter apo pajisje mobile, duhet të përditësohen në mënyrë të rregullt. Kriminelët vazhdimisht janë në kërkim të dobësive që mund të ekzistojnë në aplikacione dhe mënyrat si t'i abuzojnë ato. Ata pastaj zhvillojnë sulme të ndryshme për të abuzuar me ato aplikacione. Zhvilluesit pastaj krijojnë dhe lëshojnë përditësime për t'i rregulluar këto dobësi dhe për ta mbrojtur pajisjen tuaj. Sa më shpesh të kontrolloni dhe të instaloni përditësime aq më mirë. Shumica e platformave ju lejojnë që të konfiguroni sistemin që të përditësojë automatikisht aplikacionet tuaja mobile. Ne ju rekomandojmë ta aktivizoni këtë funksion. Nëse kjo nuk është e mundur atëherë ju rekomandojmë të kontrolloni të paktën dy herë në javë nëse ka përditësime për pajisjet tuaja mobile. Por, derisa jeni duke përditësuar aplikacionet, kujdes dhe verifikoni nëse kërkojnë ndonjë qasje të re të panevojshme..

Mëso më shumë

Regjistrohuni në buletin tonë mujor për vetëdijësimin mbi sigurinë OUCH!, qasuni në arkivat e OUCH!, dhe mësoni më shumë mbi zgjidhjet për ngritjen e vetëdijes mbi sigurinë të ofruara nga SANS duke na vizituar në faqen <http://www.securingthehuman.org>.

Edicioni në shqip

Edicioni në shqip i OUCH! është përkthyer nga gjuha angleze nga Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano. Iliri është magjistër i shkencave në administrimin e rrjetave dhe sistemeve kompjuterike, është ligjërues në universitet për lëndë të ndryshme nga fusha e TI, dhe është përgjegjës për sigurinë e teknologjise informative në bankë. Jorida është përkthyesë profesionale e gjuhës angleze në OSBE.

Burimet

Inxhinjria sociale:	http://www.securingthehuman.org/ouch/2014#november2014
Hedhja e pajisjes suaj mobile:	http://www.securingthehuman.org/ouch/2014#june2014
Mbrojtja e tabletit tuaj të ri:	http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#december2013
Shprehje të shpeshta mbi sigurinë:	http://www.securingthehuman.org/resources/security-terms
SEC575: Mobile Device Security Course:	http://www.sans.org/sec575

OUCH! botohet nga SANS Securing The Human dhe shpërndahet nën licencën [Creative Commons BY-NC-ND 4.0](http://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/). Lejohet ta shpërndani këtë buletin ose ta përdorni për programet tuaja vetëdijësuese, për sa kohë nuk e modifikoni përmbajtjen e buletinit. Për përkthimet apo më shumë informata, ju lutemi na kontaktoni në ouch@securingthehuman.org.

Bordi editorial: Bill Wyman, Walt Scrivens, Phil Hoffman, Bob Rudis
Përkthyer nga: Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano



securingthehuman.org/blog



[/secrethehuman](https://www.facebook.com/secrethehuman)



[@secrethehuman](https://twitter.com/secrethehuman)



[securingthehuman.org/gpl](https://www.securingthehuman.org/gpl)